



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 27 Datë 13. 08. 2015

PËR

“DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 32, shkronja “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” (i ndryshuar); vendimit nr.510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 20 001 – 50 000 banorë, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 50 001 – 100 000 banorë, sipas lidhjes nr.2 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me 5 001 – 20 000 banorë, sipas lidhjes nr.3 bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Administrative me më pak se 5 000 banorë, sipas lidhjes nr.4 bashkëngjitur këtij vendimi.

5. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2015.
6. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës.
7. VKB nr.50, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Bashkiake të Tiranës, (shfuqizohet).
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 20 001 – 50 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	92 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	39 000
Përgjegjës Sektori	III	b	1ose2	2%	37 000
Përgjegjës Zyre	IV	a	1ose2ose3	2%	29 000
Specialist i mesëm	IV	a	1ose2ose3	2%	29 000
Specialist i ulët	IV	b	1ose2ose3	2%	22 000
Specialist me arsim te mesëm	—	—	—	—	32 000
Arkivist	—	—	—	—	30 000
Punonjës shërbimi	—	—	—	—	27 000
Punëtor gjelberimi	—	—	—	—	26 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	25 000

Lidhja Nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 50 001-100 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	92 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	45 000
Përgjegjës Sektori	III	b	1ose2	2%	42 000
Përgjegjës Zyre	IV	a	1ose2ose3	2%	30 000
Specialist i mesëm	IV	a	1ose2ose3	2%	30 000
Specialist i ulët	IV	b	1ose2ose3	2%	26 000
Specialist me arsim te mesëm	—	—	—	—	32 000
Arkivist	—	—	—	—	30 000
Punonjës shërbimi	—	—	—	—	27 000
Punëtor gjelbërimi	—	—	—	—	26 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	25 000

Lidhja Nr. 3 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	79 500
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	31 000
Përgjegjës Sektori	III	b	1ose 2	2%	29 000
Përgjegjës Zyre	IV	a	1ose2ose3	2%	27 900
Specialist i mesëm	IV	a	1ose2ose3	2%	27 900
Specialist i ulët	IV	b	1ose2ose3	2%	22 000
Specialist me arsim te mesem	—	—	—	—	32 000
Arkivist	—	—	—	—	30 000
Shofer	—	—	—	—	27 000
Punetor sherbimi,mirëmbajtës	—	—	—	—	26 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	25 000

Lidhja Nr. 4 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë

E M Ë R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Administrator	—	—	—	—	56 100
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	26 000
Përgjegjës Sektori	III	b	1ose 2	2%	25 000
Përgjegjës Zyre	IV	a	1ose2ose3	2%	22 000
Specialist i mesëm	IV	a	1ose2ose3	2%	22 000
Specialist i ulët	IV	b	1ose2ose3	2%	21 500
Specialist me arsim te mesem	—	—	—	—	32 000
Arkivist	—	—	—	—	30 000
Shofer	—	—	—	—	27 000
Punetor sherbimi,mirëmbajtës	—	—	—	—	26 000
Pastrues, Roje	—	—	—	—	25 000